R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 3055/1 prot. Tiranë, më 26.10.2026

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektvendimin "*Për krijimin dhe funksionimin e regjistrit të posaçëm elektronik të personave të referuar ose nën hetim për vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike, të kryera me dhunë gjatë grumbullimeve dhe manifestimeve publike, shkëmbimin e të dhënave dhe verifikimet kufitare*"

MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit") ka administruar shkresën tuaj, protokolluar me tonën me nr. 3055 prot., datë 26.10.2026, nëpërmjet së cilës përcillni për mendim projektvendimin "*Për krijimin dhe funksionimin e regjistrit të posaçëm elektronik të personave të referuar ose nën hetim për vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike, të kryera me dhunë gjatë grumbullimeve dhe manifestimeve publike, shkëmbimin e të dhënave dhe verifikimet kufitare*", së bashku me relacionin shoqërues.

Fillimisht, referuar bazës ligjore të projektvendimit, mbi të cilën mbështetet krijimi dhe funksionimi i regjistrit të posaçëm elektronik, sugjerojmë që të përcaktohen edhe referencat në ligjin nr. 82/2024 "Për policinë e shtetit" i ndryshuar, i cili legjitimon përpunimin e të dhënave personale në këtë regjistër.

Gjithashtu, sqarojmë se ligji nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" përcakton parimet, kriteret dhe garancitë që duhet të respektohen gjatë përpunimit të të dhënave personale, por nuk përbën, në vetvete bazën të posaçme ligjore për krijimin e një regjistri të ri nga institucionet publike. Për rrjedhojë, sugjerojmë që të hiqet nga baza ligjore e projektvendimit togfjalëshi "*... dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale*", duke u mbajtur si referencë ligjore, siç është parashikuar në pikën 8 të projektvendimit.

Në vijim, referuar ***shkronjës "a" të pikës 3 të projektvendimit***, sa i përket togfjalëshit "*kategoria shoqërore e personit*" vlerësojmë të nevojshme të përcaktohet përmbajtja e kësaj kategorie duke shmangur ndalimin e çdo diskriminimi të mundshëm për shkak se një pjesë e tyre konsiderohen të dhëna personale sensitive.

Në përfundim, me reflektimin e sugjerimeve të mësipërme, Zyra e Komisionerit vlerëson se projektvendimi është hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi